

**UNITED  
NATIONS**

United Nations  
Interim  
Administration  
Mission  
in Kosovo



**UNMIK**

**NATIONS UNIES**

Mission  
d'Administration  
Intérimaire des  
Nations Unies au  
Kosovo

**PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**KUVENDI I KOSOVËS  
СКУПШТИНА КОСОВА  
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Ligjislatura e dytë**

*Komisioni për Shëndetësi, Punë  
dhe Mirëqenie Sociale  
Nr. 28/2007*

***PROCESVE BAL***

*i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të mbajtur më 2. 10. 2007, në sallën N-225, në orën 13.00*

**Të pranishëm:** Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, kryetare: Naim Jerliu, Shpresa Murati, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Fehmi Vula, Zylfije Hundozi, Nurishahe Hulaj, Ferid Agani dhe Zahrije Jusufi

**Morën pjesë**

- Z Dugagjin Zaberxha** nga Ministria e Shëndetësisë
- Z Feriz Haliti** nga Hendikosi
- Znj Xhylnaze Gola** Departementi për mardhaje pune

Mbledhjen e drejtoi **Fatmire Mulhaxha – Kollçaku** dhe propozoi këtë:

***REND DITE***

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar ,**
- 2 Shqyrtimi i Projektligjit për barnat narkotike ,substancat psikotrope dhe prekursorët.**
- 3 Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuar**
- 4 Të ndryshme**

**Rendi i ditës u miratua.**

U hap shqyrtimi për pikën e parë

## **1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar ,**

Pasi nuk pati vërejtje , u miratua.

U hap shqyrtimi për pikën e dytë

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit për barnat narkotike ,substancat psikotrope . dhe prekursorët**

**Fatmire Mulhaxha –Kollçaku**, përshëndeti përfaqësuesin e Ministrisë se Shëndetësisë dhe ftoi që të raportojë lidhur me vërejtjet në Projektligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët .

**Dukagjin Zaberxha** nga Ministria e Shëndetësisë dhe ne cilësi të hartuesit të Projektligjit i paraqiti vërejtjet të cilat pas një debati të gjerë Komisioni i miratoi me disa ndryshime dhe njëherit e autorizoi z. **Ferid Agani** të përgatisë amandamentet në formë tabelor të cilat do t'i dorëzohen sekretarisë se kuvendit . Komisioni i miratoi amendamentet me raport dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës për miratim.

## **3 Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuar**

Kryetarja lidhur me këtë e ftoi ekspertin që e kishte ngarkuar IND-a për të dhënë sugjerimet lidhur me Projektligjin për rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuar

**Halit Ferizi** nga Hendikosi përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi Komisionin për punën që është duke bërë në mbështetjen e kësaj kategorisë të personave me aftësi të kufizuara . Ai komentet i fokusoi në mungesën e projektligjit të punës Në vazhdim lidhur me Projektligjin ceku se ky duhet të jetë në pajtueshmëri me konventat ndërkombëtare . Ndërsa lidhur me të drejtat e njeriut kërkohet një pasqyrë objektive duke bërë një analizë krahasuese me ligjslacionin rajonal dhe BE . Lidhur me Projektligjin u tha se përbehet nga nëntë kapituj. Dispozitat e përgjithshme rregullojnë fushëveprimin ,qëllimin dhe përkufizimet dhe duhet t'i përmbahet materies se normimet e bëra me konventat ndërkombëtare Gjatë amendamentimit duhet të korrigjohen fjalitë e tekstit të Projektligjit të cilat e humbin kuptimin e nocionit të normuar me konventat ndërkombëtare Ai pastaj foli për brendinë e projektligjit dhe gjatë amendamentimit do të japë kontributin.

**Xhylnaze Gola** nga Departamenti për Mardhenie a pune i Ministrisë se Punës dhe Mirëqenies Sociale i ofroi Komisionit sqarime që kanë të bëjnë me Projektligjin dhe u vlerësuan të dobishme .

**Flora Brovina** kërkoi të vazhdohet sipas tabelës krahasuese. Ajo i paraqiti amendamentet si vijon : Amendamenti 1 ka të bëjë në ndryshimin e titullit të Projektligji për aftësimin e riaftësimin profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara. Pastaj , amendamente i propozoi si vijon: nenit 2, nenit 3,2,4,5 ,11,12,15 nenit 4.4 nenit 5.3 titullit të kapitullit III nenit 6.3 ,4 nenit 10 ,2 nenit 11,4 neni 13 ,4 neni 14.1,2 ,7 nenit 17,2 u propozua të fshihet nenit 18 i shtohet pikë e re nenit 19 ,1 i shtohet pikë re ,neni 21 fshihet neni 25,2 neni 27,1 ,3 nenit 28,1 i shtohet pikë e re

Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, Naim Jerliu, Shpresa Murati, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Fehmi Vula, Zylfije Hundozi, Nurishahe Hulaj, Ferid Agani dhe Zahrije Jusufi si dhe Halit Ferizi dhe Xhylnaze Gola kontribuan për hartimin e e amdamenteve .

**Nurishahe Hulaj** , propozoi për ndërprerjen e mbledhje dhe vazhdimin e kësaj pike për javën e ardhshme .Ajo arsyetimin e mbështeti në pamundësinë e përcjelljes së amendamentimit pasi u ndie lodhje fizike dhe psikike.

Me propozimin e saj u pajtuan të pranishmit dhe lidhur me këtë Komisioni nxori këtë :

#### P ë r f u n d i m

**Komisioni do vazhdojë me 9.10.2007 lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për rehabilitimin profesional të personave me aftësi të kufizuara**

**Të ndryshme**

**Ilaz Pireva** ngriti çështjen e mosdhënies se përgjegjjes se ministrit të Punës lidhur me Projektligjin për Inspektoratin e punës

**Mbledhja përfundoi në orën 15.30**

Procesmbajtës,  
Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

**Kryetarja e Komisionit  
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**